



Multi-Tiered Systems of Supports (Sistemet Shumënivelëshe të Mbështetjes)

Të nderuar familjarë dhe kolegë,

Ka një akronim që mund ta keni dëgjuar shpesh këto ditë—në klasë, gjatë takimeve prind-mësues, në zhvillime profesionale për stafin dhe në situata të tjera. Ky akronim është MTSS, që qëndron për Multi-Tiered Systems of Supports (Sistemet Shumënivelëshe të Mbështetjes). Edhe pse MTSS ka një emër të gjatë, kuptimi i tij është shumë i drejtpërdrejtë: çdo nxënës merr atë që i nevojitet.

MTSS fillon me një kuptim të thellë të përparimit të nxënësve. Mësuesit analizojnë me kujdes disa pika të dhënash, duke përfshirë diagnostikimet, vlerësimet, detyrat e klasës dhe të tjera, për të identifikuar nxënësit që kanë nevojë për mbështetje shtesë dhe për të përcaktuar se çfarë lloj mbështetjeje u nevojitet. Për shembull, në lexim, një nxënës mund të ketë nevojë për ndihmë shtesë në fonikë, për të përmirësuar rrjedhshmërinë, ndërsa një tjetër mund të përfitojë nga mbështetja në fjalor, për të kuptuar më mirë fjalët në faqe.

Për t'iu përgjigjur këtyre nevojave të veçanta, mësuesit u ofrojnë çdo nxënësi mësim të synuar—të quajtur ndërhyrje—në mënyrë që ata të praktikojnë aftësinë specifike, shpesh në grupe të vogla. Gjatë vitit shkollor, mësuesit përshtatin këto ndërhyrje bazuar në përparimin e nxënësve.

Shumë shkolla e kanë zbatuar MTSS për një kohë të gjatë. Por, siç kam [njoftuar së fundmi](#), tani po ndjekim një qasje në nivel sistemi për MTSS si pjesë e NYC Reads (NYC Lexon). Ne po vendosim udhëzime për MTSS në të gjithë qytetin tonë, duke përcaktuar se cilat ndërhyrje duhet të përdorin shkollat, në mënyrë që të gjithë fëmijët—përfshirë nxënësit me aftësi të kufizuara dhe nxënësit shumëgjuhësh—të kenë përvoja të mësimit cilësore dhe të personalizuar.

Me MTSS, ne po sigurojmë që nxënësit tanë të marrin atë që u nevojitet për t'u bërë lexues të aftë dhe të suksesshëm.

Në bashkëpunim,

Melissa Aviles-Ramos
Kancelare (Chancellor)

Fokusi i kancelares:

Në The Leadership and Community Service Academy (Akademia e Udhëheqjes dhe Shërbimit ndaj Komunitetit) në Bronx, MTSS është një përpjekje që përfshin të gjithë. I gjithë stafi ndihmon në zbatimin e MTSS, qoftë duke ofruar ndërhyrje apo duke mbështetur me logjistikë. Shkolla e shfrytëzon çdo mundësi gjatë ditës për të ofruar sa më shumë ndërhyrje në grupe të vogla, dhe rezultatet janë të dukshme në reflektimet e vetë nxënësve. Siç tha një nxënës, “Po përmirësohesha në çdo vlerësim” falë grupeve të leximit të shkollës.

Nominoni një person ose program për fokusin e kancelares [këtu](#).

Video Kryesore:



Për përkthime, ju lutemi vizitoni faqen tonë në [YouTube](#).

Për të aksesuar titrat e përkthyer: Klikoni mbi ikonën “CC”. Klikoni mbi ikonën “Settings (Cilësimet)” dhe zgjidhni “Subtitles/CC (Titrat/CC)”. Zgjidhni “Auto Translate (Përkthim Automatik)” dhe më pas zgjidhni gjuhën tuaj.

Lajme dhe burime nga NYCPS:

- Shikoni [mundësitë për nxënësit këtë muaj](#) në [The Morning Bell \(Zilia e Mëngjesit\)](#).
- Për lajme dhe burime të tjera, ndiqni NYCPS online në [Facebook](#), [Instagram](#), [X](#) dhe [YouTube](#).
- Këtu është [videoja javore](#) nga Kryetari i Bashkisë Eric Adams. Mund të [regjistroheni për të marrë përditësime](#) drejtpërdrejt nga Mayor's Office (Zyra e Kryetarit të Bashkisë).

Familje të NYCPS: Nëse nuk dëshironi më të merrni këtë buletin informativ, ju lutemi [çaktivizoni abonimin](#).